

28 gusht 2026,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 28.08.2026, Prishtinë

Për shpalljen e konkursit publik për përzgjedhjen e organizatorit të Superkupës së Kosovës 2026

Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që rrjedhin nga Statuti i FBK-së, përkatësisht neni 24, pas propozimit të pranuar lidhur me kriteret për organizimin e Superkupës, Bordi i FBK-së merr këtë vendim:

- 1. Shpallet konkurs publik për përzgjedhjen e organizatorit të Superkupës së Kosovës 2026**, për organizimin e ndeshjes ndërmjet KB Trepça dhe KB Bashkimi, e cila do të zhvillohet më 15 shtator 2026.
- Të drejtë aplikimi kanë klubet sportive, komunat, organizatat sportive dhe subjektet tjera juridike që dëshmojnë se kanë kapacitet organizativ, teknik dhe financiar për organizimin e Superkupës së Kosovës 2026.
- 3. Subjekti i interesuar duhet t'i plotësojë këto kushte të përgjithshme:**

3.1. Kushtet e përgjithshme

Organizatori duhet:

- të mos ketë obligime financiare të papaguara ndaj FBK-së;
- të respektojë Statutin, aktet normative, Propozicionet e Garave dhe vendimet e FBK-së, si dhe Rregullat Zyrtare të FIBA-s;
- të jetë i gatshëm të nënshkruajë kontratë me FBK-në, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve;
- të zbatojë Udhëzuesin për Organizimin e Superkupës së Kosovës në masën që dispozitat e tij janë të aplikueshme për organizimin e një ndeshjeje.

3.2. Kushtet infrastrukturore

Ndeshja duhet të zhvillohet në palestër të regjistruar dhe të aprovuar nga FBK, e cila plotëson kushtet infrastrukturore dhe teknike për organizimin e një ndeshjeje finale, duke përfshirë:

- kapacitet minimal prej 1,500 ulësesh;
- parket të miratuar sipas standardeve të FIBA-s;
- ndriçim të përshtatshëm për zhvillimin e ndeshjes dhe transmetimin televiziv;
- semaforë elektronikë dhe pajisje të kohës sipas standardeve të FIBA-s;
- sistem funksional të 24-sekondëshit;
- sistem të zërimit me cilësi të lartë;

- internet me shpejtësi të mjaftueshme për tavolinën zyrtare, statistikat dhe transmetuesin televiziv;
- furnizim alternativ me energji elektrike ose plan rezervë në rast të ndërprerjes së energjisë;
- zhveshtore për ekipet dhe personat zyrtarë;
- tavolinë zyrtare dhe tavolinë teknike sipas kërkesave të FBK-së;
- hapësira për media, miks zonë dhe sallë për konferencë për media;
- hapësira të përshtatshme për transmetuesin televiziv dhe instalimin e pajisjeve të produksionit.

3.3. Kushtet organizative

Organizatori obligohet të sigurojë strukturën organizative për realizimin e ndeshjes së Superkupës, duke emëruar së paku:

- Udhëheqësin e Organizimit;
- Menaxherin e Palestrës;
- Koordinatorin për Siguri;
- Koordinatorin për Marketing;
- Zyrtarin për Media.

Pas përzgjedhjes, organizatori obligohet t'ia dorëzojë FBK-së organogramin organizativ me emrat dhe kontaktet e personave përgjegjës.

3.4. Siguria dhe shërbimet emergjente

Organizatori obligohet të sigurojë:

- planin e sigurisë për zhvillimin e ndeshjes;
- bashkëpunimin me Policinë e Republikës së Kosovës;
- kompani private të licencuar të sigurimit;
- ekip mjekësor me autoambulancë gjatë gjithë zhvillimit të ndeshjes;
- pajisjet e nevojshme për ndërhyrje emergjente;
- sigurimin e përgjegjësisë civile për mbulimin e dëmeve eventuale gjatë organizimit të ngjarjes.

3.5. Obligimet financiare

Organizatori i përzgjedhur obligohet të deponojë shumën prej 5,000.00 € në llogarinë e FBK-së, në afatin e përcaktuar me kontratë.

Kjo shumë administrohet nga FBK dhe përdoret për mbulimin e shpenzimeve qendrore të organizimit të Superkupës, duke përfshirë:

- pagesën e personave zyrtarë të ndeshjes;
- pagesën e personave të tavolinës zyrtare;

- sigurimin e produksionit televiziv;
- sigurimin e sistemit të reklamave LED;
- sigurimin e medaljeve, kupës dhe trofeve të tjerë;
- dizajnin, prodhimin dhe vendosjen e materialeve të brandingut;
- marketingun dhe promovimin e ngjarjes;
- shpenzime të tjera organizative të miratuara nga FBK.

Organizatori mbulon të gjitha shpenzimet lokale të organizimit të ndeshjes, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- sigurimin privat;
- shërbimet mjekësore;
- qiranë e palestrës (nëse aplikohet);
- personelin teknik;
- pastrimin;
- energjinë elektrike;
- vullnetarët;
- shpenzimet tjera operative.

3.6. Marketingu, sponsorizimi dhe të drejtat komerciale

Organizatori obligohet të respektojë në tërësi dispozitat e FBK-së lidhur me:

- marketingun dhe promovimin e ngjarjes;
- brendimin e palestrës dhe fushës së lojës;
- aktivizimin e sponsorëve të FBK-së;
- vendosjen e materialeve reklamuese sipas udhëzimeve të FBK-së.

Federata e Basketbollit të Kosovës mban të drejtën ekskluzive mbi:

- të drejtat televizive të ndeshjes;
- organizimin dhe shitjen e hapësirave reklamuese gjatë transmetimit televiziv;
- sponsorin prezantues të ngjarjes dhe të gjitha të drejtat që burojnë nga sponsorizimi i eventit.

Organizatori obligohet t'i sigurojë transmetuesit zyrtar të gjitha kushtet teknike dhe logjistike për realizimin e transmetimit televiziv.

3.7. Akreditimet

Organizatori obligohet të përgatisë dhe administrojë sistemin e akreditimeve në përputhje me udhëzimet e FBK-së dhe të sigurojë kontrollin e hyrjes në të gjitha zonat e palestrës. Dizajni dhe kategoritë e akreditimeve miratohen nga FBK.

3.8. Media dhe ceremonia zyrtare

Organizatori obligohet të sigurojë:

- miks zonën dhe sallën për konferencën për media;
- kushtet për punën e mediave të akredituara;
- realizimin e ceremonisë para dhe pas ndeshjes sipas skenarit dhe udhëzimeve të FBK-së.

3.9. Të drejtat e organizatorit

Organizatori ka të drejtën e të ardhurave nga shitja e biletave për ndeshjen e Superkupës.

Çmimet e biletave, kontingjenti i biletave për klubet, sponsorët, partnerët dhe mysafirët zyrtarë të FBK-së miratohen paraprakisht nga FBK.

3.10. Dokumentacioni për aplikim

Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë:

- kërkesën për organizim;
- përshkrimin e kapaciteteve organizative;
- përshkrimin e palestrës ku do të zhvillohet ndeshja;
- emrin dhe kontaktet e personit përgjegjës;
- dokumentacionin tjetër të kërkuar nga FBK.

Afati dhe mënyra e aplikimit

- Aplikacionet duhet të dorëzohen më së largu deri më 3 shtator 2026, ora 17:00, në adresën elektronike sekretare@basketbolli.com.
- Aplikacionet e dorëzuara pas këtij afati nuk do të merren në shqyrtim.
- FBK do të shqyrtojë aplikacionet dhe do të shpallë organizatorin e përzgjedhur më 4 shtator 2026 në ora 17:00.


Për organizimin e Superkupës së Kosovës 2026, Udhëzuesi për Organizimin e Superkupës së Kosovës shërben si dokument referues dhe zbatohen vetëm ato dispozita që janë të aplikueshme për organizimin e një ndeshjeje.

FBK rezervon të drejtën të mos e përzgjedhë asnjë organizator nëse e vlerëson se asnjë nga aplikimet nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

